# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-450938**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rendi i Ditës - Sot seancë plenare/ 5 ministra japin llogari në Kuvend - Vendoset edhe për pagat e magjistratëve |
| ADRESA | `https://www.syri.net/politike/917236/sot-seance-plenare-5-ministra-japin-llogari-ne-kuvend-vendoset-edhe-per-pagat-e-magjistrateve/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 06:06:04 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 06:02:38 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `27d295bcc5848c268eec3d153a38f0147d54d06363a943a060582892e122963f` |
| TEKSTI | `719f68fec470804e8a745051385d4e467220cf062830954565d8a05a6a584eef` |
| PAMJA | `6ce347b11f985974e6f3014d7eb08792d27d8c747d85f4e58fc6f0ef4d65d4df` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `2352c6f3b132ff14eb227b7deed49e22e971b3d3c8e07bcb3e63771744c262be` |
| E MËPARSHMJA | `eec27e9df3e100b5988f8f913359169d2ca5dd424dd75f9bdb61fea882cb85bc` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/2352c6f3b132ff14eb227b7deed49e22e971b3d3c8e07bcb3e63771744c262be`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



SONILA MEÇO
'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



ÇIM PEKA
Tradhtia që s'e panë tu ardhë



# Sot seancë plenare/ 5 ministra japin llogari në Kuvend - Vendoset edhe për pagat e magjistratëve

08:02, 17/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

+ A[a] -

**Kuvendi do të zhvillojë sot seancën plenare, ku në rendin e ditës janë parashikuar disa interpelanca urgjente të kërkuara nga deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, si edhe shqyrtimi dhe votimi i disa projektligjeve dhe projektvendimeve.**

Sipas njoftimit të Kuvendit, seanca do të nisë me miratimin e procesverbalit të seancës plenare të 8 shtatorit dhe më pas do të vijojë me njoftimet. Në fokus të seancës do të jenë katër interpelanca urgjente me ministra të qeverisë, ndërsa një tjetër interpelancë është kërkuar nga deputeti Blendi Himçi.

Në vijim, deputetët do të shqyrtojnë marrëveshje dhe projektligje që lidhen me Ukrainën, inteligjencën artificiale, sektorin e ullirit, pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, disenjot dhe tregun e shoqërive me ofertë publike.

Në fund të seancës janë parashikuar edhe ndryshime në përbërjen dhe drejtimin e komisioneve të përhershme të Kuvendit, si dhe diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

**Rendi i plotë i ditës**

Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 8 shtator 2026.
Njoftime.
Interpelancë urgjente me Ministrin e Mjedisit, Sofjan Jaupaj, kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.
Interpelancë urgjente me Ministrin e Punëve të Brendshme, kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.
Interpelancë urgjente me Ministren e Arsimit, Mirela Kumbaro, kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.
Interpelancë urgjente me Ministren e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Klodiana Spahiu, kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.
Interpelancë me Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, Enea Karakaçi, kërkuar nga deputeti Blendi Himçi.
Projektligji "Për ratifikimin e Konventës për Themelimin e Komisionit Ndërkombëtar të Kërkesave për Ukrainën, bërë në Hagë, më 16.12.2025".
Pas pyetjeve do të shprehet nismëtari, ndërsa do të paraqesë qëndrimin Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike. Do të japin

më të lexuarat

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyç

'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhduket historia

PD: Shpopullimi i Shqipërisë, një krizë që po zbraz vendin dhe po rrezikon të ardhmen e tij

mendim edhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik dhe Komisioni për Europën dhe Punët e Jashtme. Më pas do të zhvillohen diskutimet e grupeve parlamentare dhe do të hidhet në votim.

Projektligji "Për ratifikimin e Konventës kuadër të Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Shtetin e së Drejtës".
Projektligji do të shqyrtohet pas pyetjeve, me qëndrimin e nismëtarit dhe të Komisionit përgjegjës për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik. Mendim do të japin Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike dhe Komisioni për Europën dhe Punët e Jashtme. Pas diskutimeve të grupeve parlamentare do të zhvillohet votimi.

Projektligji "Për pranimin e vendimit DEC-I 1/119-VI/2024, të Këshillit të Anëtarëve të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit, për ndryshimin e nenit 36 të Marrëveshjes Ndërkombëtare për Vajin e Ullirit dhe Ullinjtë e Tavolinës, 2015, aderuar me ligjin nr. 112/2017".
Për këtë projektligj do të shprehet nismëtari dhe Komisioni përgjegjës për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural. Mendim do të japin Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat dhe Komisioni për Europën dhe Punët e Jashtme. Pas diskutimeve do të zhvillohet votimi.

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar".
Projektligji do të shqyrtohet me pyetje, qëndrimin e nismëtarit dhe të Komisionit përgjegjës për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike. Mendim do të japin Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik. Më pas do të zhvillohen diskutimet dhe votimi.

Projektligji "Për disenjot".
Pas pyetjeve dhe qëndrimit të nismëtarit, do të shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë, Punësimin dhe Financat. Mendim do të japin Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, Komisioni për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Komisioni për Europën dhe Punët e Jashtme. Projektligji do të kalojë më pas për diskutim dhe votim.

Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10236, datë 18.2.2010, 'Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike'".
Pas pyetjeve dhe shprehjes së nismëtarit, do të paraqesë qëndrimin Komisioni përgjegjës për Ekonominë, Punësimin dhe Financat. Mendim do të japin Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike dhe Komisioni për Europën dhe Punët e Jashtme. Në vijim do të zhvillohen diskutimet dhe votimi.

Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr. 85/2026, 'Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit'".
Projektvendimi do të hidhet në votim.

Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr. 86/2026, 'Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit'".
Edhe ky projektvendim parashikohet të kalojë për votim.

Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr. 87/2026, 'Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit'".
Projektvendimi do të hidhet në votim me shumicë të thjeshtë.

Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.
Në këtë pikë, çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta, ndërsa nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, koha maksimale është 8 minuta. Koha totale e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.

© SYRI.net

Lexo edhe:


Provokimi i gazetës gjermane: Pra perëndimi bashkëpunoi me një kriminel lufte


Mbyllet protesta e 109-të, protestuesit: Nesër në dyert e Kuvendit!


Djali i Hashim Thaçit: Beteja nuk ka mbaruar, historinë e UÇK-së nuk mund ta ndryshojë asnjë vendim

Urimi dhe mesazhi i Metës: PISA janë një tjetër dëshmi e gjendjes alarmante të shkollave! Për PL-në arsimi prioritet

'Selimi dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal, mori pjesë në kryerjen e krimeve'

Ngërçi me pagat/ Gjykata e Kukësit mbyll dyert për qytetarët 3 ditë

## TË NGJASHME

VIDEO/ Vendimi i Hagës, Martens: UÇK-ja nuk lindi nga asgjëja, nuk duhet të humbasim gjykimin historik

Gjenerali i NATO-s: Jam i shokuar me vendimin e Hagës! Thaçi nuk është kriminel

Familjarët e viktimave të Reçakut të revoltuar me dënimin e ish-krerëve të UÇK-së

Protesta e 109-të/ Pas fjalimeve, rinis marshimi në Tiranë: Rama, jepe dorëheqjen!

Franca pas verdiktit të Hagës: Vendimi mund të apelohet, mbështetja për pavarësinë e Kosovës e palëkundur

Protestuesi i përgjigjet Ramës: Marre të qoftë, ushtrove presion në Kosovë për ngritjen e Gjykatës Speciale

‘Nuk do të shembemi nga asnjë sulm’/ Kalaja: Fitorja bashkë do të jetë e padiskutueshme!



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.